



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:230435  
Datë: 12.01.2023  
Numri i dokumentit: 03851563

C.nr.3251/13

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Egzon Mujaj, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit B.K e S, me seli në Prishtinë, rruga “Lidhja e Pejës”, pa nr. kundër të paditurit N. A, nga fshati V, rruga “F. A”, nr. 181 - P, me objekt të kontestit rimbursimin e dëmit, me vlerë të objektit të kontestit në shumë prej 1,270 €, jashtë seancës më datë 12.01.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PËR SHKAK TË PADËGJUESHMERISË / MOSBINDJES

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit B. K e S, me seli në Prishtinë, rruga rruga “Lidhja e Pejës”, pa nr. ashtu që DETYROHET i padituri N. A nga fshati V, rruga “F. A”, nr. 181 - Prishtinë, që paditësit në emër të rimbursimit të dëmit t’ia paguaj shumën prej 1,270 €, me kamatë ligjore siç e paguajnë bankat afariste të Kosovës, si për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, nga data 11.12.2013, (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi më datë 11.12.2013, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit për rimbursimin e dëmit, duke kërkuar që të detyrohet i padituri që paditësit në emër të rimbursimit të dëmit t’ia paguaj shumën prej 1,270 €, me kamatë ligjore, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore ka nxjerr aktvendimin për përgjigje në padi, me datë 03.08.2022, të cilin i padituri e ka pranuar me datë 10.08.2022. Me aktvendimin për përgjigje në padi gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës

në padi dhe për pasojat e ligjore që do të ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësin që gjykata të nxjerr aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë.

I padituri pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, në këtë çështje juridike kontestuese nuk ka jep përgjigje në padi.

Gjykata në kuadër të autorizimeve ligjore në kuptim të dispozitave nga neni 150 i Ligjit për Procedurën Kontestimore pasi vlerësoi kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë, gjeti së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë.

Gjykata i vlerësoi të gjitha kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit siç parashohin dispozitat nga neni 150 par. 1 nën (a), (b) dhe (c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe atë së të paditurit i është dorëzuar padia dhe aktvendimi për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi, në rastin konkret nga provat e dorëzuar me padi vërtetohet fakti se me datë 18.02.2005, në ora 10:35, kishte ndodhur aksident trafiku me fajin e të paditurit i cili nuk kishte police të vlefshme të sigurimit.

Gjykata në kuptim të dispozitave të cituara nga neni 150 të LPK-së, e në lidhje më dispozitat nga neni 18 par. 1 dhe 4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Ligji Nr.04/L-018 (në tekstin në vijim do të përdoret shkurtesa LSDA), ku është paraparë se “personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”, dhe par. 4 ku thuhet se “Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”, andaj gjykata gjeti së kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për kamatën, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 277 të LMD-së, të vitit (1978), pasi që raporti juridik (ngjarja), ka lindur në kohën kur ky ligj ka qenë në fuqi. Ndërsa si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurit për pagesën e kamatës gjykata ka caktuar datën e paraqitjes së padisë.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve për taksë gjyqësore për padi 20 €.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. 3251/13, datë 12.01.2023

Gjyqtari  
Egzon Mujaj

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.